VENDIM
Nr. 40, datë 16.10.2015

PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR PROGRAMIN "SHQIPËRIA DIXHITALE", PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", të ndryshuar, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte për programin "Shqipëria dixhitale", pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore e vendore, si dhe institucionet e organizatat për zhvillim, agjencitë zbatuese e zhvillimore, qendrore e vendore, projektet e të cilave miratohen për t'u financuar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin në sekretariatin teknik pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik dhe zbatimit të projektit e të përdorimit të fondeve, si dhe emrin e personit përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të projektit.

3. Autoritetet kontraktuese për projektet, sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e projektit deri në fund të muajit dhjetor të vitit 2015, përveç projektit nr.2, për të cilin duhet të kryhen procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e projektit brenda muajit shkurt të vitit 2016. Për fondet e projekteve të paprokuruara sipas këtyre afateve, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën të rishqyrtojë financimin dhe t'i rishpërndajë fondet e këtij financimi për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike të kryejë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve, pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama